



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave



100 Vjet Pavarësi

V E N D I M

Nr. 418, datë 27.06.2012

PËR

PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE
TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE
TË QEVERISJES QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësit e emëruar me kohë të pjesshme në përbërje të këshillave, bordeve apo komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore përfitojnë një pagesë për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në këto organe, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Në kuptim të këtij vendimi, në njësi të qeverisjes qendrore përfshihen të gjitha institucionet qendrore buxhetore apo që financohen nga buxheti.

Nuk janë objekt i këtij vendimi organet drejtuese të njësive të fondeve speciale si dhe organet drejtuese të institucioneve kushtetuese dhe të pavaruara që funksionojnë sipas përcaktimeve të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”.

3. Emërtesa e çdo këshilli, bordi apo komisioni, numri i anëtarëve në përbërje të tyre, numri maksimal i pagesave në një vit pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera, si dhe masa e pagesës së kryetarit dhe anëtarëve për çdo këshill, bord ose komision përcaktohen në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe

është pjesë përbërëse e tij, me përjashtim të rastit kur ligji specifik parashikon ndryshe.

4. Përjashtohen nga e drejta e pagesës sipas pikës 3, të këtij vendimi, kategoritë e mëposhtme:
 - a) Funkionarët politikë, nëpunësit civilë dhe punonjësit e administratës shtetërore, të cilët janë përfaqësues me të drejtë pagese në më shumë se 2 (dy) këshilla, borde apo komisione.
 - b) Punonjësit organikë të ministrive dhe institucioneve buxhetore, në përbërje të komisioneve dhe këshillave, në funksion të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
 - c) Punonjësit organikë të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në përbërje të bordeve, komisioneve dhe këshillave, në funksion të kësaj ministrie.
 - ç) Punonjësit organikë të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave në përbërje të komisioneve, në funksion të këtij institucioni.
5. Për shpërblimin e nëpunësve të emëruar në komisionet e mëposhtme, në ndryshim nga pika 3, e këtij vendimi, do të veprohet, si më poshtë vijon:
 - a) Për komisionin e posaçëm për miratimin e materialeve të përkthyer të legjislacionit të Bashkimit Europian në shqip, pranë Ministrisë së Integritit, masa e shpërblimit të nëpunësve në përbërje të tij përcaktohet sipas kriterëve të udhëzimit të përbashkët të ministrit të Integritit dhe të ministrit të Financave.
 - b) Për komisionet e posaçme të shpronësimit, në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, masa e shpërblimit të nëpunësve në përbërje të tyre, është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo vendim shpronësimi të miratuar.
 - c) Për Komisionin Rajonal Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë, në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, masa e shpërblimit është 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për kryetarin dhe 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për anëtarin, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera në një muaj.
 - ç) Për Komisionin Epror Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë, në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, masa e shpërblimit është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj për kryetarin dhe 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për anëtarin, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera në një muaj.

- d) Për Komisionin Mjekësor Qendror për Përcaktimin e Verbërisë, në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, masa e shpërblimit është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj për kryetarin dhe 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për anëtarin, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera në një muaj.
6. Shpenzimet për kryerjen e pagesës së punonjësve në përbërje të këshillave, bordeve apo komisioneve të ndryshme të njësisve të qeverisjes qendrore, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje, si dhe çdo shpenzim tjetër i natyrës operative (jo shpërblim), të kryer për realizimin e detyrave të këshillave, bordeve apo komisioneve, përballohen nga institucionet përgjegjëse për krijimin e këshillit, bordit apo komisionit, brenda buxhetit vjetor, të miratuar për këtë institucion.
 7. Çdo përcaktim i masës së shpërblimit apo pagesës për pjesëmarrje në një këshill, bord, komision apo grup pune në njësitë e qeverisjes qendrore, e parashikuar me akte të tjera nënligjore, shfuqizohet.
 8. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 qershor 2012.

K R Y E M I N I S T R I

SALI BERISHA

This document was created with Win2PDF available at <http://www.win2pdf.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.
This page will not be added after purchasing Win2PDF.